

Bordi i Drejtorëve i KRU “Hidromorava”-sha Gjilan, në mbështetje të nenit 21 të Ligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrje Publike, Kodit të Etikës për Ndërmarrje Publike dhe Qeverisjes Korporative, nenit 20 të Statutit të KRU “Hidromorava”-sha, dhe nenit 18 të Rregullores mbi përshkrimin e vendeve të punës shpall këtë:

### RISHPALLJE KONKURSI

**Për plotësimin e pozitës:**

- Pozita : Zyrtar i Lartë Financiar ( ZLF)
- I përgjegjet : Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv
- Nr. i ekzekutuesve: 1
- Paga: Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve
- Kohëzgjatja e kontratës së punës: 3 vite, me mundësi vazhdimi
- Vendi i punës: Gjilan
- Orari i plotë: 40 orë në javë

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Zyrtari i Lartë financiar do të menaxhoj çështjet financiare të Kompanisë nën drejtimin dhe mbikqyrjen e Bordit të Drejtorëve (BD) dhe Kryeshefit Ekzekutiv (KE) në përputhje me legjislacionin primar dhe sekondar të menaxhimit të ndërmarrjeve publike;
- Mirëmbanë llogaritë e Kompanisë të azhuruara me kohë dhe saktësi;
- Bën kontrollin e brendshëm financiar duke përfshirë pranimet e parave të gatshme dhe pasuritë themelore;
- Monitoron llogaritë e pagueshme – arkëtueshme;
- Koordinon pagesën e faturave dhe blerjeve;
- Rishikon shpenzimet e të punësuarve për të siguruar pajtueshmërinë me politikat e Kompanisë dhe buxhetin, para pagesës së tyre ;
- Përgatit të dhënat e Kompanisë për auditim;
- Menaxhon thesarin e Kompanisë, vendos dhe përgatit buxhetin dhe çfarëdo detyrë tjetër financiare të përcaktuar nga KE apo nga Bordi i Drejtorëve;
- Përgatitë dhe raporton për gjendjen financiare të Kompanisë në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimin financiar dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Përgatitë pasqyrat financiare të Kompanisë sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Standardeve Kosovare të Kontabilitetit;
- Raporton në Administratën Tatimore të Kosovës dhe institucionet tjera që kërkohen sipas ligjit
- Përgatitë buxhetin dhe ia ofron për aprovim Bordit të Drejtorëve të Kompanisë;
- Bashkëpunon me auditorin e jashtëm dhe të brendshëm për çështje të auditimit dhe bënë implementimin e rekomandimeve të cilat dalin si rrjedhojë e një auditimi të brendshëm, të jashtëm apo nga çfarëdo organi tjetër këshillues apo ofrues i sigurisë financiare;
- Bashkëpunon me zyrtarët tjerë të Ndërmarrjes siç janë: Kryeshefi Ekzekutiv, Auditori i Brendshëm, Sekretari për arritjen e objektivave të Ndërmarrjes;
- Kryen detyra tjera të dhëna nga Bordi i Drejtorëve dhe Kryeshefi Ekzekutiv.

#### Kualifikimet dhe aftësitë:

- Të ketë diplomë universitare – fakulteti ekonomik - drejtimi përkatës;
- Të ketë së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale nga fusha e financave ose kontabilitetit;
- Përparësi do të jetë kontabilist/e i çertifikuar nga ndonjë autoritet financiar i licencuar nga KKRF-ja apo ndërkombëtar;
- Të ketë integritet të lartë moral e profesional;
- Njohja e gjuhës angleze konsiderohet përparësi;
- Njohuri të avancuara në përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe pakove standarde softwerike;

#### Përshtatshmëria profesionale:

- Ti plotësojë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087;
- T'i plotësojë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2. pikat (d, f, j, l, dhe i) të Ligjit për Ndërmarrjet publike nr. 03/L-087;
- Gjatë periudhës tridhjetë e gjashtë /36/ muaj para datës së aplikimit nuk ka qenë Drejtor i Bordit të kompanisë Hidromorava;

#### Dokumentet e kërkuara:

- Kopja e diplomës universitare të fakultetit ekonomik – drejtimi përkatës;
- CV-në ;
- Letër motivimi (jo më shumë se 500 fjalë);
- Dëshmitë për kualifikime tjera profesionale;
- Dëshmitë e përvojës së punës;
- Pasqyrën e kontributit pensional (nga Trusti);
- Deklarata nën betim sipas neneve 17.1 dhe 17.2. të Ligjit të NP;
- Çertifikatën (dëshminë) se nuk është nën hetime më pak se 6 muaj;
- Kopjen e pasaportës ose të letërnjoftimit (shtetas i Republikës së Kosovës);

Afati i aplikimit është 21 ditë nga dita e shpalljes publike të konkursit në webfaqen e KRU "Hidromorava", në gazetë ditore, në tabelën e shpalljeve publike të Kompanisë.

Afati i aplikimit është nga data **26.08.2022 deri me datë 15.09.2022 ora 16:00.**

Aplikacionet e kompletuara dërgohen në postën elektronike në email adresën:

***rekrutimi.hidromorava@yahoo.com.***

Aplikacionet e dërguara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen, kurse ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen..

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontakohen.

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve  
Habil Zeqiri